



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti



**Komuna e Prizrenit**  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

**Drejtoria për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik**

**KOMUNA E PRIZRENIT**

## **THIRRJE PUBLIKE**

**Për të gjithë Organizatat Joqeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës që veprojnë në Komunën e Prizrenit, programi i punës, i cili është i fokusuar në fushën e turizmit dhe zhvillimit ekonomik, që përfshijnë aktivitetet të realizuara në Komunën e Prizrenit, të aplikojnë në mbështetje financiare duke u bazuar mbi rregullorën me nr. – 04/2017 për OJQ**

### **Udhëzues për aplikantë**

Data e hapjes së thirrjes:  
12.03.2023

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve:  
01.04.2023

## Përmbajtja

<i>1. MBËSHËTETJE FINANCIARE PËR PROJEKTET E OJQ-VE NË FUSHËN E TURIZMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK</i> .....	3
1.1. Problemet të cilat synohet të adresohen përmes kësaj thirrje.....	3
1.2. Objektivat e thirrjes dhe prioritetet për ndarjen e fondeve.....	4
1.3. Vlerat e planifikuara të mbështetjes financiare për projektet dhe totali i thirrjes.....	4
<i>2. KUSHTET FORMALE TË THIRRJES</i> .....	5
2.1. Aplikuesit e pranueshëm: kush mund të aplikoj? .....	5
2.2. Partnerët e pranueshëm në zbatimin e projektit/programit .....	6
2.3. Aktivitetet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes .....	7
2.4. Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes .....	8
2.4.1. Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme .....	8
2.4.2. Shpenzimet e papranueshme.....	9
<i>3. SI TË APLIKONI?</i> .....	9
3.1. Forma e përshkruese e projektpropozimit .....	9
3.2. Përmbajtja e formës Buxhetit .....	10
3.3. Ku ta dorëzoni aplikimin? .....	10
3.4. Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve .....	10
3.5. Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje? .....	10
<i>4. VLERËSIMI DHE NDARJA E FONDEVE</i> .....	11
4.1. Aplikacionet e pranuar do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme:.....	11
4.2. Dokumentacion shtesë dhe Kontraktimi .....	12
<i>5. KALENDARI INDIKATIV I REALIZIMIT TË THIRRJES</i> .....	12
<i>6. LISTA E DOKUMENTEVE TË THIRRJES PUBLIKE</i> .....	12

**1. MBËSHTETJE FINANCIARE PËR PROJEKTET E OJQ-ve NË FUSHAT E TURIZMIT, TURIZMIT KULTUROR , FUSHAT E ZHVILLIMIT TË TURIZMIT RURAL, FUSHAT E ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE ARTIZANAL**

**1.1 PROBLEMET TË CILAT SYNOHET TË ADRESOHEN PËRMES KËSAJ THIRRJE PUBLIKE**

Me këtë synim Komuna e Prizrenit ofron përkrahje për asociacione dhe shoqata, te cilat veprojnë dhe aktivitetet e tyre i ushtrojnë në fushat e turizmit dhe të zhvillimit ekonomik, ku ofron mbështetjen e tyre me transparencë të plotë dhe pa kurrfarë diskriminimi.

Në këtë vijë Komuna e Prizrenit synon rritjen e llojllojshmërisë së aktiviteteve, tërheqjen e numrit sa më të madh të publikut në këto aktivitete, tërheqjen edhe të turistëve përmes aktiviteteve të krijuara nga ana e OJQ-ve për promovimin e turizmit dhe aktiviteteve të të gjithë qytetarët.

## 1.2 OBJEKTIVAT E THIRRJES DHE PRIORITETET PËR NDARJEN E FONDEVE

Objektivi/objektivat e përgjithshme të kësaj Thirrje është që Komuna e Prizrenit ofron përkrahje për OJQ-të, dhe asociacionet nga fushat e turizmit dhe zhvillimit ekonomik pa kurrfarë diskriminimi.

Objektivat specifike të kësaj Thirrje janë:

### **Në fushën e turizmit :**

- Promovimi dhe afirmimi i vlerave në fushën e turizmit;
- Promovimi i trashëgimisë kulturore;
- Kontribimit në shtrirjen e kalendarit dhe aktiviteteve përgjatë tërë vitit;
- Kontribimit në zhvillimin e turizmit kulturor lokal;

### **Në fushën e zhvillimit ekonomik:**

- Ngritjen e kapaciteteve ekonomike,
- Zhvillimi i ndërmarrësisë përmes aktiviteteve të OJQ-ve.

Mbështetje financiare publike do të kenë:

Të gjithë OJQ-të dhe asociacionet që aktivitetet e tyre do të zhvillojnë në Komunën e Prizrenit.

## 1.3. KOSTOJA MINIMALE DHE MAKSIMALE E MBËSHTETJES FINANCIARE

Kostoja minimale e mbështetjes së projektit do të jetë me vlerë prej **1.000,00** euro.

Kostoja maksimale e mbështetjes së projektit do të jetë me vlerë prej **5.000,00** euro.

## **1. KUSHTET FORMALE TË THIRRJES**

### 1.1. Aplikuesit e pranueshëm: kush mund të aplikoj?

1. Të gjithë OJQ-të, shoqatat, që janë të regjistruara në Ministrinë e Administratës Publike - (për të dëshmuar këtë kërkesë, OJQ-ja aplikuese duhet të dërgoj kopjen e certifikatës së regjistrimit me rastin e aplikimit);
2. Të ketë zotësi juridike, financiare dhe operacionale për zbatimin e projektit;
3. OJQ-të, shoqatat të cilët veprimtaria e tyre është e fokusuar në fushën e turizmit dhe zhvillimit ekonomik në Komunën e Prizrenit;
4. Të ketë kryer të gjitha detyrimet tatimore dhe kontributet tjera të detyrueshme në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës;
5. Të mos jetë në proces falimentimi, në proces të shuarjes, në procedura të mbledhjes së detyrueshme apo likuidimit;
6. Të gjithë aplikuesit që i kanë përmbyllur projektet paraprake të mbështetura nga Komuna e Prizrenit.